

VALTER MEMISHA

MARTIN CAMAJ DHE LEKSIKU I MUNGUAR

Martin Camaj është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqiptare dhe autori më me peshë në diasporën shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore. Vepra e tij, ndër të tjera ka edhe *përmasën e vetë gjuhësore të spikatur*, sepse ai pandërprerë u shqua *për kërkim e krijim gjuhësor*, duke u vetjakësuar me vlera e prurje të shumta. Shkrimtaria e M. Camajt karakterizohet nga thukësia e lakonizmi, nga thellësia e laryshia e shprehjes. Fjala në çdo varg e rresht e gati kudo është poetike. Poezia dhe proza e tij kërkojnë lexim të ngadalshëm, jo se janë shkruar në gegërishte, por, sepse, si palimpsesti, ato janë shumështrësore dhe kumtet që transmentojnë, janë të shumta.

Edhe pse M. Camaj jetoi larg lexuesit shqiptar dhe i munguan efektet e receptimit të drejtpërdrejtë prej tij, prapëseprapë vepra e krijuar, si ka vërejtur kritika, e njeh si mjaft të gjallë bashkëbisedimin me këtë lexues. Dhe shqipja e fjala shqipe ishte kryefjala e punës së tij. Ai, jo njëherë, do t'i drejtohej auditorit gjerman, se “*dishroj që dhe publiku i këtuhit ta ketë para sysh se unë flas dhe mendoj si Dukagjinës i Shqipnis*”, duke qenë, kështu, i pandarë nga vendlindja dhe i lidhur pazgjidhshmërisht me gjuhën shqipe, mundësitë shprehëse të së cilës i shfrytëzoi si rrallëkush. Ishte gjuha amtare, e cila e mbajti shqiptar derisa mbylli sytë. Fjala shqipe, nga faqja e parë e veprës deri tek e fundit, ndjek relievën e mendimeve e të përjetimeve të tij *në kohë dhe në hapësirë*. Vepra sjell leksik nga thellësitë e shekujve e nga shekulli XX, nga mjedisi mbarëshqiptar e nga ai arbëresh. Fjala e tij shënon e laton bukur e pastër, me thjeshtësi e me mençuri, si fjala e njerëzve të thjeshtë e të zgjuar dukagjinas. Në fillimet e krijimtarisë së M. Camajt dhe në fazën e parë të saj, në prozë e në poezi, gjejmë një gjuhë që shpesh i përket ligjëritimit të zakonshëm letrar, pa dykuptimësi e nënkuptime të dendura. Por, hap pas hapi, gjuha e veprës bëhet më e ndërlikuar, më opake, me ambiguitete e konotacione, me shumëkuptimësi e shtresëzime, duke shkuar deri në simbolikë.

Ndaj, krejt natyrshëm, leksiku i kësaj vepre është një nga fushat që kërkon studim të plotë e të përimtuar. Ky leksik, në shumicën e vet, i ka munguar shqipes së sotme. Poeti e dinte dhe ndiente kur pohonte se “Pse

ishte natë, kur nisa me folë / në vetmi më ra dimni në fjalë”¹. Është puna jonë e detyrimi ynë ndaj kontributit të M. Camajt në kulturën kombëtare që ta largojmë këtë dimër, i cili vazhdoi padrejtësisht për dhjetëra vjet, ta zbulojmë e ta zbritim peshën e vlerën e fjalës së tij shqipe, sepse për këtë autor, si për rrallë tjetër, “*në fjalë sqarohet qiell e dhe bashkë*”².

Janë bërë përpjekje për t’u marrë me leksikun dhe fjalëformimin e veprës së M. Camaj³, por puna është vetëm në fillesat e veta. Është vlerësuar e duhet vlerësuar më tej puna e bërë nga M. Elezi te *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2005, që pasqyron një pjesë nga kjo pasuri. Por shqipja standarde duhet patjetër të plotësojë zbrazëtinë e krijuar nga mungesa e pasurisë leksiko-semantike që gjendet jo vetëm te ky autor, por në gjithë letërsinë e autorëve gegë, çka është vënë në dukje shpeshherë dy dhjetëvjeçarët e fundit⁴.

E. Koliqi, duke analizuar romanin “Djella” thotë se “*me një leksik e një frazeologji të zhdërvjellun, - me një siguri vizatimi tipash të ndryshëm, me një gjallni djalogësh qi me premín plot vështirësi të tyne zbulojnë fundet e shpirtit të vetjeve, me një stil të rrasët e të ngjyrshëm ku hijet dhe dritat ternohen me mjeshtëri të natyrshme, - Camaj në pak faqe krijon një botë të vogël që vuan e gzon para syvet tanë.*”⁵ Dhe është fakt i pamohueshëm se jo vetëm “Djella”, por gjithë vepra e këtij krijuesi shpërfaq një pasuri të jashtëzakonshme leksikore, frazeologjike e semantike.

¹ M. Camaj, *Fjala*, Vepra, 3, Tiranë, 1996, f. 206

² M. Camaj, *Fjala*, Vepra, 3, Tiranë, 1996, f. 194

³ Veçojmë këtu T. Osmani, *Çështje të leksikut dhe të fjalëformimit në faqet e një reviste*, në “Gjuha dhe shkrimtari”, Shkodër, 2001; M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006 etj. por edhe K. Petriri, A. Klosi, Berisha etj., që janë marrë me studimin shkencor të veprës së tij letrare.

⁴ Studiuesi M. Çeliku thekson se “Një pasuri ende të pashfrytëzuar deri më sot, ose të shfrytëzuar shumë pak, përbën letërsia e autorëve gegë, sidomos leksiku dhe frazeologjia e pasur e veprave të autorëve shkodranë e kosovarë. Shih më gjerë M. Çeliku, *Çështje të shqipes standard*, Tiranë, 2009, f. 365. Në veprat e tyre mund të gjejmë me mijëra njësi me vlera emërtuese, semantike, konotative, stilistikore, paradigmatisht, fjalëformuese etj. Ky proces tashmë është pranuar dhe është një nga sfidat e shekullit të ri. A. Dodi pohon se “pasuria gjuhësore e gegërishtes, leksiku, disa elemente të nënsistemeve të tjera, pas rivlerësimit të mjaft shkrimtarëve të shquar që kanë shkruar në gegërishte, duhet të zënë vend më të gjerë në gjuhën letrare standarde dhe të bëhet pasuri e përbashkët e shqipes” A. Dodi, *Gjuha letrare shqipe përballë rreziqeve që e kërcënojnë*, në Letërsia shqipe dhe gjuha letrare”, Prishtinë, 1998, f. 233

⁵ E. Koliqi, *Arti i Martin Camajt*, në Martin Camaj, Vepra 1, Tiranë, 1996, f. 145

Leksiku i veprës së M. Camajt përfshin *njësi të njohura, pak të njohura a të panjohura* dhe mund të kundrohet nga disa prerje. Autori shquhet për njohjen e thellë të pasurisë leksikore e semantike të shqipes dhe ai jo vetëm e përdori fjalën shqipe zotësisht, por edhe ripërtëriu pasurinë e madhe që skajonte sidomos në veriperëndim të vendit. Ai shquhet për njohjen e thellë të mundësive dhe të aftësive të mëdha të shqipes për krijimin e njësive të reja dhe vetë krijoi me qindra e qindra. Ndaj, së pari, fjalori i veprës së tij përbëhet nga dy grupe të mëdha njësish: nga *grupi i njësive nga leksiku i gjuhës amtare* dhe nga *grupi i njësive të krijuara nga vetë Camaj*.

Leksiku mund të vështrohet edhe nga *prerja stilistikore*, duke dalluar leksikun e prozës dhe atë të poezisë, dhe, brenda tyre, fjalë të ligjërimit bisedor, fjalë të ligjërimit libror dhe fjalë të ligjërimit poetik. Brenda fjalësit, gjejmë gjithashtu, shtresa historike e kulturore, shtresën mbarëshqiptare dhe atë krahinore të fjalëve. Leksiku i veprës na sjell botën materiale e shpirtërore të dukagjinave e të arbërëshëve, të qytetit të Shkodrës dhe të fshatrave të Malësisë, të reales e të mitit, sjell kulturën shqiptare dhe atë perëndimore. Aty gjen gjithçka e tërësisht shqip. Po japim një dy shembuj me fjalë të rralla, që vijnë nga të folmet arbëreshe: *Gratë, në kohën e mbasdrekës, kur dielli nxente ma së forti, u shkepën* përronit, nën katund tue la tesha. (Shkundullima, Vepra 4, f. 93); *Tytësinë* len ai këtu..., *tytësinë* nuk e merr me vete. (Shkundullima, Vepra 4, f. 118); *Katundi, ndonëse i këllatun* në gjumë, me qindra kamine pa tym, po i afrohen përsëri, papritmas, syve të mi. (Shkundullima, Vepra 4, f. 121); *Unë jam grue me ganjun* e burrë që shurben vetëm gjysmë moti e s'kam pajë e *turresë* të blejë çdo vjet rroba të reja. (Shkundullima, Vepra 4, f. 111) etj.

Fjala në prozë e në poezi gjeti mjeshtrin, i cili shpalos përmes saj artin e vet magjik dhe aftësitë e tij krijuese. Duhet theksuar se **në prozën** e M. Camajt, ndër të tjera merr jetë jo vetëm fjala shqipe e ajo geqe, por edhe shumë fjalë të reja, të krijuara prej tij sipas gjedheve të shqipes, që përbëjnë *një pasurim horizontal të fjalorit mbarëkombëtar*. Do të mjaftonin dy tre shembuj vetëm me çifte kuazihomonimesh a çifte antonimike, për të treguar se si mjeshtri lodron me fjalën shqipe: **Err e terr** në kambë, nuk i pushonte goja. (Shkundullima, Vepra 4, f. 153); *Sosja e tij zgjoi të gjith, njoftë e panjoftë*. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 87); **Lagë e ndragë** në borë e akull. (Shkundullima, Vepra 4, f. 154); **Matesh e shmatesh** si pulë që don me fluturue në tra. (Rrunga..., Vepra 4, f. 176); **Pyeti Jera qesh e ngjesh**. (Rrunga..., Vepra 4, f. 183); S'u bie ndërmend **as të këmurren, as të këpurren**. (Rrunga..., Vepra 4, f. 209); Këta lenin jashtë

vetëm krenat e shëmtueme, **të përhimë e të përthimë**, që të merrnin frymë. (Rrunggaja..., Vepra 4, f. 215); **Mendo, shmendo**, në fund iu duk se gjeti zgjidhjen. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 36); **Flenë veshë e ngjeshë** ke votra, në pritje. (Njeriu..., Vepra, 2, f. 221); **Ndezi zjarrin e fikun në hinin djegë e përdjegë** në votër. (Pleqnime..., Vepra, 2, f. 221); **Matë e shmatë, në andërr e në zhgjandërr** (Vepra, 3, f. 25) etj.

Kurse në poezinë e autorit më shumë *ndihet pasurimi vertikal*, sepse në shumëkush gjen me qindra shndërrime semantike të shumta, që çojnë në lindjen e kuptimeve të reja, të nuancave a të ngjyimeve semantike. Poezia e tij ka gjithçka: *mendim, ide, ndjenjë, simbol, ritëm, imazh, muzikë, kumt*. Dhe fjala, e qëmtuar prej mjeshtrit dhe përdorur mjeshtërisht prej tij, është çelësi që i zbulon ato. Kjo fjalë zbulon si poeti *emocionin e kthen në gjuhë* dhe si *lexuesi gjuhën e kthen në emocion*, edhe pse fjala e poetit shpesh del jashtë shtratit kuptimor të njohur a të kodifikuar. Por këtu fillon ngjizja, procesi i lindjes së kuptimeve të reja, i zgjerimit të aftësisë shënuese të fjalës shqipe, e cila spikat në këtë drejtim. Nga pena poetike lindin qindra kuptime të reja, të cilat përdihen në një proces të shkallëshkallshëm, që nga përdorimet e figurshme deri te kuptimet e figurshme. Këto ngjizen në struktura sintaksore dygjymtyrëshe a më të gjera, duke çuar në përqendrimin e marrëdhënies nga shprehja e figurshme te fjala, te zgjerimi i strukturës së saj kuptimore. Proceset e metaforizimit dhe të metonimizimit janë të pranishme gati në çdo krijim. Edhe pse në poezinë “*Nji poeti të sotëm*” M. Camaj thotë: “*Vargjet e tua janë për t’i lexue në heshtje / e jo para mikrofonit / si të çetës së poetëve të tjerë.*”⁶, unë po lexoj vetëm 4-5 prej tyre ku këto procese bien menjherë në sy: “*Ai rresht i vjetër, krah-thatë, / më rrin përpara me shkrola t’thyeme, / I prekun aty këtu shpesh me penë të kuqe / kullon gjak. / Varg i pazbutun! / Dardhë e egër në shkamb.* (Vepra, 2, f. 153). Po kështu edhe në vargjet “*Mendimet ranë shkokrueshëm / prej pergamenës mes gishtave / për tokë e u banë copë-copë.*”

Natyrisht që në poezinë e Camajt gjejmë shumë përdorime të figurshme, që ngelen në rrafshin e stilistikës letrare: *Flakën e synit ta due mes fushës / e zemrën tande mollë / të ndemun në degë. / Mos bzaj para muzgut / të njerzishëm në fushë / e erës zemërgjanë / që përqafton çdo maje bari. / Lule, hiqe pëlhurën e zbehtë prej hanës / e shtroje për tokë.* (Vepra, 2, f. 117); *Dashunija e tingujve të violinës / për erën e Jugut digjet mbi ullijt / e zdashun.* (Vepra, 2, f. 64); *Poezia niset marrshëm, kinse tue u endë / shikon e dashunueme në vete / shemblesën e vet n’pasqyrë e brrakave.* (Vepra, 2, f.

⁶ M. Camaj, Vepra, 2, Tiranë, 1996, f. 199

75); Natën zjarmi u fsheh / në zgaurren e drunit të fortë / e fjet qindrueshëm pa qenë dëshmitar / i turbullimit të hanës mes reve / mbi alpe. (Vepra, 2, f. 74); Mimosat erdhën tue pru me vehte / ngjyrën e ditëve të blera / afshin e zemrave që rriten nga një fije / për ditë, pëshpëritjet e egra e të lehta / të atyne që shkelën në prakun e jetës / me kambë të dyshimta, me frigë. (Vepra, 2, f. 94); Kujtimi përpushet qepallash / në luftë me gjumin e randë. (Vepra, 2, f. 64); Ndër duert e shpijave në lugajë / dritat puthin flokët e bijës së nanës. (Vepra, 2, f. 115); Gjijet e shkambijve janë veshë të shurdhë. (Vepra, 2, f. 124); E deti me vala lëpin bregun në gjumë. (Vepra, 2, f. 132); Degët e pemës janë dejë / degët e saj përgdhehin qiellin me gishta / e qielli lëshon dritë. (Vepra, 2, f. 133); Ka me ardhë pranvera / dhe ernat kanë me përqethë fytyrën e lumit. (Vepra, 2, f. 134); Mendimet ranë shkokrrueshëm / prej pergamenës mes gishtave / për tokë e u banë copë-copë. (Vepra, 2, f. 222); Vetmija e natës tëhollon flokët / e vashës së dashunueme. (Vepra, 2, f. 69) etj.

Por për leksikografinë të rëndësishme janë kuptimet e reja, të cilat përsëri janë me dhjetëra e me dhjetëra: Djella shprishej ndër rreze dhe **djega** për të shtoej ndër mue. (Djella, Vepra, 1, f. 79) Në atë **ngushtim** e rroku zemra e burrit të fortë... (Shkundullima, Vepra, 4, f. 150); **Për ta mbresë** mirë në tru, iu avit ma afër. (Shkundullima, Vepra, 4, f. 115); Dy lloje tymi, i drunit dhe i duhanit, **trajtonin** bashkë, mbi krye të Nikës, një shtresë të dendun mjegulle. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 81); Por me të tanë **rojen** e vet, Lena mbeti edhe dy herë të tjera me barrë. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 11); Ata **theknin** kambët për të mos humb fillin e kuvendit me të. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 68); Kola, burrë **i peshuem** në fjalë e në sheje, dinte të largonte çdo rrezik plangut e familjes. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 29); Edhe pse **të pakullueme**, thashethanat mund të sillnin grindje mes Nikës e të bijve. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 31); Por atë mbrame lotët e së bijës iu dukën se po i rrjedhin asaj, jo për faqe, por përmbrenda parzmit, prej fytit në **kokërr** të zemrës. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 35); Sille e mbështille si të dush, - ia **mbeti** Gjergji. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 63); Ndonëse nuk **ua shpërblente** goja, përjetonin ditët ma të bukura të jetës. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 79); Ai ia këputi (i zuri) rrugën inxhinierit. (Shkundullima, Vepra, 4, f. 104); Kemi probleme mat të ngutshme se sa **të qesim (të ndërtojmë)** ura mbi Përroin e Thatë. (Shkundullima, Vepra, 4, f. 105) etj.

Po listojmë disa kuptime të tjera të reja, pa dhënë përdorimin e tyre në fjali: tret (kohën, rrugën), e ngushtoj tepër (e vë në pozitë të vështirë), shtrëngohem (në kallçikë leshi...), ndal (marr), (lakra) të mardhura, paqësoj (qetësoj), (mure) të leckueme, kalues (kalimtar), shkepem (lodhem), kund (diku), ngjit (menjëherë), e dendun (e mbushur) me pluhur, i prishun (i çmendur), njomzë (foshnjë), familje e ngjitun (e lartë), përqethja (rrëqethja), pishë (në pishë të diellit), i lëshuem (i braktisur), (me za) të shterrun,

grimcohem (i dhimbnin), fyelli i kaminit (tubi i oxhakut), pishë (në pishë të diellit), i lëshuem (i braktisur), (me za) të shterrun, grimcohem (i dhimbnin), fyelli i kaminit (tubi i oxhakut), e vë për fije, mjellazë (e rrezeve), e kulloj (mirë një punë), cirkë (dridhmë), trimnesha të prishuna (të çartura), ther (pickoj: si me e pasë therë gjarpri në gji), ndal (mbaj: e kisha ndalë për vete), maza (e tokës) etj.

Në rrafshin e kuptimeve tërheqin vëmendjen edhe disa përdorime si shfaqje të veçanta të valencave semantiko-gramatikore të shumë fjalëve, si përdorime të rasës rrjedhore pa parafjalë në ndërtime sintagmash foljore; përdorime interesante të kalimtarësisë së foljeve etj: *E shoqja ankonte se kishte hjekë keq tanë jetën.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 79); *Kur Lena ktheu në vërri, u tha të bijve se i jati i tyre nuk ishte mirë me shëndet.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 82); *U dashunova në atë birin e sat motre.* (Shkundullima, Vepra, 4, f. 123); *Haji me atë tim nip që kurrë nuk do të martojë (nuk do të martohet).* (Shkundullima, Vepra, 4, f. 125); *E bija e atij që dikur vrante e kthillte në atë vend, kishte një rrjet ndikimi të fortë në popullatë.* (Shkundullima, Vepra, 4, f. 131); *Si qenin, ashtë dashtë me e gjuejtë gurë* (Djella, Vepra, 1, f. 131), *Ashtu si bijnë prej lisave / degët e vrame stuhije.* (Vepra, 1, f. 208) etj.

Në veprën e M. Camaj artistike i gjen fjalën dhe njësinë frazeologjike. Po ndalemi vetëm në përdorimin e disave njësive frazeologjike në thënie: *Sot e gjithë ditën nuk i ba buza gaz.* (Djella, Vepra, 1, f. 101); *Qiste në gjuhë burrat e malit për të tregue përralla e urti.* (Djella, Vepra, 1, f. 89); *Edhe mue toka si bisha, ma ka pru shpirtin në fyt, por kur të zbutet e qet vjetin tue e marrë me të mirë.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 24); *Meqenëse lexonte shumë, trajtonte fjali të gjata e të kapërthyeme, pa marrë frymë, pa i ra synit qepallë.* (Rrunga në mars, Vepra, 4, f. 163); *Dhe të gjithë i niste me një grusht miza në shpinë dhe me fjalë të randa.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 12); *Nëse ndokush, - tha ai,- don me hy në pyll pa supatë, me gjalë të tjera, të zhbirojë shortet e Shtojzovalleve, le ta bajë!* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 19); *Tash qenkej ma i peshume në fjalë e në punë se i vëllai.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 19); *E kam qitë cekën me të martue, por maparë do vu themele në këtë plangë.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 21); *He!- ia priti Mitri që ishte i vetmi ndër bij të cilit ia shpërblente goja lajkën.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 32); *Atit ynë duket se i kanë ra trutë në qafë,- vërejt Mitri-, pse tash së fundi flet maje në maje.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 35); *Nuk e paska ai moshën me hjekë kreni si djalë njizetvjecar me këso lajlash në qafë e në parzm.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 37); *Shkoqi sytë soje e tha se i shoqi nuk qenka për atë këmishë.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 37); *Me ata i kishin ra fjalët ma mirë se me burrat e pleqnisë e të kanunit, si Kola me shokë.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 65) etj.

Ne kemi vjelë e përzgjedhur rreth 500 njësi frazeologjike, një pasuri vërtet e admirueshme për veprën e një autori, edhe pse një pjesë e tyre janë të njohura dhe të pasqyruara në fjalorë. Ato nuk po i sjellim në trajtën normative apo përfaqësuese (si zë frazeografik), por si i kemi gjetur në përdorim: *mirë e përfillë, ka dalë hatullash, bëhet bujenë, i ra mali mbi rye, i ra huji për qen, më doli shputë, asht e lëkurë, sikur t'i kishin ra gishtat në mjaltë, si lisna për gurë e tokë, i vinte gjaku në krye, birë në zemër, (ishte) thikë e brisk, ma dha vejen pa të kuq, i rrëshqiti vendi, teh më teh, këput e sos, këput e mbaro, si gjizë e zieme, si kusi e shpueme, kullot sytë, me dreqën në sy; e qit mendësh, i ka pru ngushtica, është shurdh nga një vesh, pus i pafund, e vë në rrabush, e kish pikë në zemër, më shkon për dore, iu ngushtue zemra, e kish kërkue në kashtë e në sanë, me i ra në fije, ka marrë keq në thue, si dordolec mbi lakna, (s')e çoj vrra në vrra, gisht për gisht, sa çon miza në krah, (nuk) i merrte për të randë, i ngjit dorën, i thirrun e pathirrun, njoftë e panjofhtë, lodh mendjen, si pika në lis, i shkriu mardhën, në pikë të ditës, në pikë të natës, ka dalë pune, e shikonin kokërr në sy, kulm e themel, shtie krye, sa t'i plasë faqja, i shtie zekthat, i lëshuem zemre, mori në iri, i japë majë, u bane fjala e dheut, rimon në mëndje, me lëvizje dreqnish në sy, si vetima për së kthjellti, pa i ra synit qepallë, mes dy mendesh, si qen i lëshuem pas darke, grindej në zemër, i hap derë e dritare, si vena e vjeçme (si vera e vjetër), i vidhte me sy, e ndava zemrën dysh, i ndrumë në njëqind çelësa, ka frenjtë në dorë, kishte marrë të djegun, ka i lëshuem kulari, me marrë gojë, err e terr, si i liruem prej burgut, si t'i kishin hy pesëqind dreqën në bark, i bie kambana, u kap në kambë, (humbi) këpucë e shputë, i prunë terrin e natës në sy, bjerr mendësh, e dalun gjaje e malli, lagë e ndragë, i mori për të randë, i shtie gverrin, i dha këmbës përpjetë, ka helm në zemër, me i shti të ligën, iu kullua në tru, i ka mbetur në qafë, e shtie gojën në grusht, e qes fare; i kadhën malin, bëj dorë, me sy të ngordhët, ka qitë cekën, me akull të mendes, gjarpër nën gurë, vidë e butë, pëllumb i egër, shegë e mbyllun, gurë mullini, shtrat merimange, shoh me sytë e zemrës, shkoj me qiri fikun, pa ba ver me gojë, nuk i di shtek vetes, më xuni djega, i lëshoj frejtë, i dalun vendit, me katër palë sy, qiste në gjuhë, i zë dritën e diellit, si breshka nën rrashtë, si vjedulla në vjeshtë, zog i pakrahë, si kalë i ligshtë, e bëj kubël, i bëftë shpirti dritë, me sy të shtjerrun, me sy të malluem, gjarpër nën gurë, pa cak e pa qëllim (kot), (e njeh) si xhepin e vet, as me qenë ndër kuja, sa me i plasë rrashtën, sa të bie në zjarr e në ujë, në gjuhën e djepit, në gjuhën e tamblit të gjiut, bie në fashë, rrin si ndër splica, si kokrrat në shegë, si mazë qepe, e sjell gunën mbrapsht, si miza në kërcu, i plasi rrashtën, e kanë kapur dreqnit, ia çon shtatin ushël, e çoj punën vrra në vrra, tash e parë, (luaj) si qeni me sukull, mace e mi, si bisht kali ndër miza e zektha, me birë në zemër, si ta kishte therë blea, i bie terri në sy, lak pa nyja, merr amë, si maca në zall, bluej në zemër, i bamë rrak, i lë*

hijen, pula e dreqit, qen shtrungu, i ka sytë e ligshhtë, vë gojë (në diçka), rrufe mbi lis, i ra në hundë, i çohet goja lang, i lë shteg vetes, kokërr mbi kodër, e vë për fije etj.

Si thamë më lart, pasuria e vjelë mund klasifikohet në fusha dhjetëra fusha tematike (leksiko-semantike), për të cilat nuk po ndalemi, por po japim një pasqyrë statistikore e ilustruese të fjalëve sipas përkatësisë leksiko-gramatikore.

Me një punë jopërfundimtare kemi vjelë nga 5 vëllimet e para rreth 300 emra, shumica e të cilëve dalin për herë të parë, kurse një pjesë e tyre, që gjenden të pasqyruar në fjalorët shpjegues kombëtarë, sjellin kuptime, nuanca e ngjyrimë të reja kuptimore etj., d.m.th., që nuk janë pasqyruar më parë në këto vepra, si *fatlumësi, mëgojë, qiellzanë, terramot, vegullimë, buzanë, rrogacë, kashtallë, plogësi, ngrohësi, fshehësi, hapësi, shllim, lëbozë, gjakasanas, gjamatar, vëllamje, turesë, rrugim, vëllath, moh, shtëri, fejë, tërvësë, shtangim, shkundullimë, murth, tubë (shokësh), rrogje, kodër (e hundës), ndinollë, gjumësi, dangë, bashkëlojtar, shpërrallim, rrungajë, katundëse, rojë, mbërrelë, hirrëz, llomështi, lulim, bashkërrjedhje, shkandull, nynyrim, pushimtarët, zaullimë, papërndalje, ndërkohë, qot, gëvalle, veshlepuri, lëmashk, shqetësi, cangël, shurdhukull, spjerrak, mirakande, gjojë (gjueti), zhytër, mardhë, zgurë, ujëvarës, shmang, dalmëni, pikatësi, cakël, mjellazë, ngrijë, nusak, ngrohës, hajneshë, përblumje, pusak, gresë, sendgja, lëmuetësi, qypqi, e padrejtë, babgjyshe, skajim, mashkulli, marrëfrymje, rangtore, shpendbardhë, frymëshkurte, ujëpërçues, kthjellësi, zhgushullim, çmendore, breshnizë, reskeqe, balçim, pikëndeshje, bashkëvendës, bjerraditës, qindvjet, kap (i qiellit), kapërthim, shkac, lëpizë, tureçkë, paduresë, përvijë, mirënjohësi, ashkëz, mrekkullim, sherri, paburni, përqethje, mendjeshquetësi, përkuesi, mirëditës, shkullojë, gopësi, gjithëditë, gërresë, tërfojë, purrizë, fasholl, zokth, laknishte, skërfejz, gungore, mirëbërës, pabesim, flakim, mjeltore, zoteshë, hylleshë, rravgues, purriz, mendull, përpushje, mbetuni, pafajni, shregull, qikutë, çubë, veshlepur, hep, kërcëllatje, kothër, brushtullinë, gargaliq, shkreti, gopç, njomzë, endir, shqitëz, neth, tamërr, gungallë, karajel, gilicë, gërlac, bludë, nënqafë, gjinim, mbulojcë, shtjellës, kalesë, rysni, zijë, larmëni, nusi (dhoma e nusesë), eratim, udhëtreguese, gockëz (guaskë), rrëfanzë, pafajni, gjithnatë etj.*

Kemi gjetur e përzgjedhur rreth 100 folje, shumica e të cilave, përsëri, nuk gjenden në fjalorë shpjegues kombëtarë, si *mbërrel (vetullat), mbërrelem (në fytërë), përvështirësohem, përbluaj, përkënaq, përkënaqem, skapullohem, murrem, zguroj, shkundullis, përqeth, përnjësoj, përpushem (përpiqem), përndal, përndalem, gërthej (vetullat), urëtoj, qëllimoj, përdihem, përnjësoj, shpluhnoj, prapoj, përbuj, përbuhem, shporoj, pridhem, mbastoj, çukurmoj, sendësoj, carr, përlavdoj, ngris, kokrroj, nynyrrat, shkarravend,*

tejshoh, tejshihem, stërklart, ngurëzoh, zhëmërohem, kërthnes, kërthnesem, përnjësoj, mërdhazem, tërfat, tërfatem, përbind, grith, lëvyr, lëvyrem, mbrustem, këllatem, pehatem, radhoj, radhohet, sqepoj, drasht, shkimbem, shkapetem, këlluq, këlluqet (thyhet), kadem, përdjeg, përdigjem, shtangoj, shtangohem, gzhaz, përrshkoj, grimcoj (mjekrën) etj.

Kemi gjetur e përzgjedhur rreth 300 mbiemra, si *gojëleshuem, i thamtë, i acarueshëm, i kajshëm, i kajshëm, i përkujdesuem, i përbotun, i hipnotizuem, dokënor, i zbrumë (në djesë), i rrezitun, (fshatra) të lëshueme, zanaltë, i përmoçëm, i palisa, i përnximë, përndyes, i motnuem, mëkatnues, i kueshëm, i lëngueshëm, i mungët, kryemëzat, flokrupç, djalëshkretë, përgojues, i erandshëm, kacinë (hollake), veshhollë, dyfaqesh, i përbotun, i jonatyrshëm, i stërdjegur, buzëshpërvjelun, i rrëpijtë, i grimcuem, i flakruem, shqerrës(e), i rrezikueshëm, i turrshëm, e shqymun, fanor(e), i pëshpëritun, i përngeshëm, i plleshëm, i përkujdesuem, i parranjë, i picakët, i ngucun, i shtanguem, i përblozun, i zdramët, i pathirrun, i gropuem, (vite) të rrëpira, i padhe, i lagsitun, sytrim, i curaktë, i hjedhët, i stërkequn, burrakoc, i stërpjekun, i papërjetuem, i palandë, birnor(e), i përbrendshëm, i përngeshëm, shtahjedhët, i kujtueshëm, i zbardhemët, i shzemëruem, i pashtresë, i palot, qafëkëputun, i mungullueshëm, i lavrueshëm, i llomitun, flakëligishtë, i zhburmuem, buzëmprehtë, ballëshpërvjelun, qymegjatë, i përkujdesun, kryeulë, kurrizlakuem, i përandjeshëm, i pashueshëm, shtinjarak, i lëndurun, i përthimë, i kërthnestë, i zhubluem, bulëmadh, drumirë, i lëbozët, kokërandë, frymëshkurtë, truperrët, gjumëlehtë, buzulli, kurmshlligë, mërgues, i pavarrueshëm, barkrrjepun, vjeshtore, i gëzhatshëm, qafëvjedull, veshimët, e mëngjestë, mjekërpakrehun, kripbardhë, i pambërritshëm, i përrjargun, kurmkëputun, i lulmë, kryevogël, i përmykun, buzëpërgjakun, dheas, kryeçot, latrac, i ndërhandshëm, i mjedisëm, nynyruet, i brohoritshëm, i vangët, i përndjekur, shegan (i kuq në fytyrë), i zbardhemët, i ngacmuar, goclar(e), i shqetë, i shtitëruem, shtiratës(e), kryeshtypun, zemërpezull, i stërhollë, i lazdrueshëm, i vrashtë, i përvojshëm, i travajuem, i mbresun, keqtingëllues, zgurpërgjakun, i andshëm, gojëplakë, i rruzullt, frymëmirë, zashtjerrun, i shtanguem, i pashtitëruem, i murtajshëm, i lypun (për gjak), i burrënueshëm, i grishun, i mërdhazun, i skjartë, krekar(e), i lezmë, i vetueshëm, buknor, i argëtuem, kryeshpatuk(e), syzbrazët, i nënzashëm, i mënershëm, brijëlëmuet, zgurëplotë, lëkurëhollë, i pamirë, i shkitshëm, sykokërr, lëkurëmurmë, i gërrisun, i unshëm, lukthshtjerrë, magror(e), i lulmë, leshgalmë, i curratun, i pagjurmue, vithegjanë, i guruem, i përndalun, i paprind, i përngeshëm, fytyrimët, i rrezitun, i kuqlemët, turmec, i padhe, i zhgushullueshëm etj.*

Kemi gjetur e përzgjedhur rreth 200 ndajfolje, si *andrrueshëm, durueshëm, përngadalë, dijekeqas, lëmuç, ushël, kukë, shoqnueshëm, kujtueshëm, pakujtueshëm, depërtueshëm, lëmuç, ngathshëm, përngut,*

hallakatshëm, turpnueshëm, këndellshëm, gëzhatshëm, kambëqyqe, habitshëm, mistershëm, qëndrueshëm, përqendrueshëm, turbullueshëm, zjarrmueshëm, urdhnueshëm, përzireshëm, panjoftë, disesi, idhnueshëm, theksueshëm, mahnitëshëm, shkathtas, rrethazi, mpishëm, feshk, gulshueshëm, kujdesshëm, padurueshëm, turrshëm, rrethazi, vëmendshëm, pavëmendshëm, thellueshëm, mbërthyeshëm, spikatshëm, kraekrah, plogshtë, kurrnjë, kundrueshëm, tërbueshëm, dikah, lëmueshëm, atypëratyshëm, ulurueshëm, idhëshm, shkullojë, zashëm, kokërrueshëm, përdhunë, mpijshëm, ngulshueshëm, ngurrueshëm, shumueshëm, çubëza-çubëza, ironikisht, vutas, dikund, nënçmueshëm, lëmueshëm, mbuluetas, mosbesueshëm, pushueshëm, pendueshëm, mpishëm, gjithëmbarë, krah e krah, preshëm, mynxyrshëm, shkepshëm, mbys mbi mbys, tërbueshëm, thupër, kryeneças, kryepeshë, zhgrehshëm, denjueshëm, pajtueshëm, drojshëm, danga-danga, fill e fill, cik më cik, për së kithi, ngulmas, mënishëm, zhbirueshëm, preshëm, përngeshëm, përkundshëm, lakueshëm, buzëhapët, drojshëm, pakuptueshëm, pushueshëm, deshtazi, shkrifshëm, përçudë, kryeneças, joshtazi, pamjeshtërisht, pahiri, ndërrueshëm, përkueshëm, përpishëm, rrakel, ngulshueshëm, kambasharavelas, pavetëdishëm, përçmueshëm, madhnueshëm, mundshëm, tërkuzë, pusishëm, përvëlueshëm, përzireshëm, thekshëm, padashë, mjegullueshëm, zilishëm, unshëm, saktas, shlireshëm etj.

Në veprën e e M. Camajt të tërheqin vëmendjen edhe një numër i vogël pjesësh të pandryshueshme të ligjëratës, si lidhëzat *nëmos*, *posaçe* (sidomos) etj.; ndonjë përemër i pacaktuar, si *kurrqjasend* etj.; ndonjë pjesëz, si *mun* (madje, mbase) etj.

Leksiku i munguar në fjalorët shpjegues kombëtarë, por që gjallon në veprën e këtij autori dhe në vendlindjen e tij, mund ta shohim edhe sipas mënyrave dhe tipeve të fjalëformimit. Në krijimtarinë e tij gjenden jo pak fjalë të parme nga leksiku popullor, por shumica dërrmuese e fjalëve janë jo të parme, të qëmtuara a të krijuara. Ne gjejmë formime në sistem si dhe njësi të derivuara të veçanta, si segmente të vargut fjalëformues, por që nënkuptojnë lehtëzi se edhe njësitë e munguara, gjenden patjetër në ligjërimin e M. Camajt apo në ligjërimin popullor ku është mbështetur gjuha e tij. Edhe këtu po japim shkurt disa nga prurjet:

Prejardhja është mënyra kryesore dhe më prodhimtarja në krijimin e fjalëve të reja që përfshihen në fjalësin e vjelë, duke zënë vend parashtesimi, prapashtesim dhe parashtesim-prapashtesimi.

a. Tek parashtesimi do të veçonim formimet mbresëlënëse me parashtesën **për-**, të cilat formojnë një grup paradigmantik interesant njësisht: *E dinte se përralla janë ato, por ua kishte lakmi treguesve të përngeshëm e pa të keq të cilët përkënaqeshin të shtireshin ma fëmijë se fëmijët.* (Rrunggaja në mars, Vepra, 4, f. 168); *Me këtë përfytyrim, të afërt me*

atë të kangëve kreshnike, donte **me përlevdue** Nikën... (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 29); Nika **u përndal** e s'i tha se atij s'i binte ndërmend. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 38); Nganjëherë i banin veshët se ai fshan mbas shkurreve **tue u pëtrrollë** me gra të tjera. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 51) etj.

Po kështu vlera jo të pakta shënuese e stilistikore sjellin edhe formimet me parashtesën **pa-**: Iu duk **paurti** t'ia lëndojë plakut e vetes varrën e vjetër. (Rrunga, Vepra, 4, f. 225); **Palëvizja** ishte rranjosë thellë në miset e fytyrave e deri në palcën e eshtnave... (Shkundullima, Vepra, 4, f. 94); Shpjegoi thjeshtë e me një shej **padurese** në za. (Shkundullima, Vepra 4, f. 111); Mitri, nëse i binte rasti, me u kënaq tue vu në lojë njerëz **të pakeq** sy më sy, solli rreth e rreth sytë. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 32) etj.

b. Prapashtesimi sjell në faqet e veprës shumë fusha leksikondajshesore. Po veçojmë, ndër të tjera formimet **temë foljore + (ë)si**: Për Jerën mbestë gjithsesi **fshehësi**. (Rrunga, Vepra, 4, f. 169); Vetja e shumëvujtun papritmas rrezatonte **ngrohësinë** që rrjedh prej zezonës së përgjithshme. (Shkundullima, Vepra, 4, f. 154); Ngjan se u kanë dhënë shkas banorëve të Vilës, të marrin me mend se **qenësitë** / qeniet fshehësi-plotë ndër gurra mund të ishin vetëm Zana e Orë, gjithnjë në kërkim trevash të vetmueme. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 33-34) etj.

Tërheqin vëmendjen formimet me **-o**: S'e hapte gojën as me lypë që dikush t'i ndihmonte nisa **mjeshtro** (për piquej me mjeshtëri), si, për shembull, t'i mbante ndokush një skaj dërrase nisa ai sharronte. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 48); I jati, Gjuri, në mallin e mashkullit që do të kishte folë e do të ishte sjellë po sikur ajo, **heshtonte**, ulte kokën dhe ndëgjonte me vëmendje, pakëz i turpnuem para shokësh të cilëve nuk u kandej liria e tepërt e vajzës që përzihej në kuvende burrash. (Rrunga në mars, Vepra 4, f. 163); **Prapoje**, Zot, të keqen! (Pishtarët..., Vepra 4, f. 48); E të bijtë? - pyeti Gjuri, gati **me e trashue** grindjen. . (Rrunga, Vepra 4, f. 133) etj.

Në veprën e M. Camajt nuk mungojnë:

-formimet me **-ar**: Mandej i mprehu në grihë për të pre qymen në to, si **hekurar** i vërtetë. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 49) etj.

-formimet me **-as**: Njerëzit enden parqeve në blerim e çdo njeni asht **dheas** (Njeriu..., Vepra, 2, f. 235); Atëherë filluen të lëviznin edhe gishtat e saj **shkathtas**. (Shkundullima, Vepra, 4, f. 110) etj.

formimet me **-ash**: Unë jam **gojash** e mund të më shpëtoj e të flas. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 63) etj.

-formimet me **-or(e)**: Ajo shtresë **mungullore** e shqetësonte të zotin e Gurrave. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 79); Toka **zhurorë** në pus e pinte hellin e ujit si kurrqjasend. (Pishtarët ..., Vepra, 4, f. 26); Këta në veshë e mbathë në petka **festore**, largoheshin ndonjëherë. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 27) etj.

-formimet me **-to**: Vitoi gërtheu vetullat, mori gotën e verës e aviti te buza dhe, mbasi **erëtoi** (i mori erë) mendueshëm, duket se e gjeti fillin e arsyesimit të vet. (Shkundullima, Vepra 4, f. 129) etj.

Formimet me **-shëm** dalin si mbiemra dhe ndajfolje, që shpesh janë formime paralele. Ato janë nga më të goditurat dhe me vlera të gjithanshme: shënuese, shprehëse etj.. duke treguar dhe një herë veçantinë e gegërishtes në këtë tip fjalëformimi: Aq i **pakujtueshëm** nuk je, - iu sjell Leka të jatit. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 56); Copën e arit e quante me zbunim, **përgëdhelshëm**, rrasatik, në përfytyrimin e tij, diçka si mrekullibamëse. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 42); Prej vrojtimeve të tilla Nika mori me nxanë mend mos me u ngut dhe me veprue **kujtueshëm**... (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 11); Turfullonte **idhnueshëm** dhe e pyeste. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 12); Fjalët e tij burrnore tmerronin shtazë e njerëz dhe depërtonin jehonë në jehonë prej shkambit në shkamb dhe shuheshin tue ra në pushim larg ndër gjije e humnere, - **përkueshëm**, si petk i mbajtur prej të njëjtit trup, sepse andej pari shungullonin vetëm zani i Nikës e bubullima e motit të keq, **ndërrueshëm** simbas rastit e kohës. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 13); Leka e uli zanin **pajtueshëm** e tha... (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 31); Nika tue folë për të shoqen i shkokërronte fjalët **shijueshëm**. (Pishtarët e natës, Vepra, 4, f. 32); Nika gruen e vetë e shikonte **lakmueshëm**... (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 40); Çdoherë që këqyrte ashtu përreth, **hutueshëm** mbas gjase të atyre që e shikonin, zbulonte diçka që nuk ishte në rregull. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 48) etj.

Një nga grupet paradigamtike më interesante, në veprën letrare të M. Camajt është ai i emrave formuar me **-esë**: Me kohë, grueja mësoi të llogarisë kur i shoqi acarohet, kur **duresa** e tij çohet valë e derdheje dhe vinte e shfrynte. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 12); Shumëkujt i mërzhitet **gjallesa** në këto vise. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 24) etj.

Ka formime dhe me prapashtesën **-in(ë)**: Prej perëndimit të diellit deri në muzg **avullina** ndërronte dukje prej minuti në minut. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 33) etj.

Ka formime me prapashtesën zvogëluese **-zë**: Përpiu **njomzën** e frymës së detit në rropulli dhe u kënaq. (Mprehje, Vepra, 3, f. 59) etj.

c. Nuk mungojnë edhe formimet parashtesoro-prapashtesore: Nika tue folë për të shoqen i **shkokërronte** fjalët shijueshëm. (Pishtarët e natës, Vepra 4, f. 32) etj.

2. Formimet me përbërje, në veprën e M. Camajt, nuk kanë prurjen dhe begatinë numerike, si prejardhja, por kanë begatinë semantike: Ajo e ka vendin në lëvizje, aty ku ashtë, si plak **gjakmardhun** në kandin ma të mirë pranë zjarmit. (Mprehje..., Vepra, 3, f. 95); Grindja në familjen e Pukajve nisi mbas **vdekzotit** të shtëpisë, të jatit të shatë bijve. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 9); Ti që **frumëshkurtë** / pse guri në mal s'e ndieu / peshën e vargjeve të tua.

(Lirika..., Vepra, 2, f. 51); Kola, **fjalëmbarë** e i kuptueshëm, don me thanë, prorre gati për t'u bindë e pranue çdo pikëpamje të huej e cila s'i sillte dam, e quante Nikën arnzell i vetmuem. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 29); Për këtë, Nika **kryekërcyem** bante mirë të të veçohej. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 29); Qeniet **fshehtësiplotë** ndër gurra mund të ishin vetëm Zana e Orë, gjithnjë në kërkim trevash të vetmueme. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 33-34); Duhet ta marri vesh malësia, kishte thanë me vete Lena, se unë nuk jam **lukshjtjerrë** si Zanat, unë jam dikush tjetër. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 36); Të nesërmen u gjetën në takim... tre të zotët e shtëpive të vëllaznisë së Arrasve, kushrij të parë, të gjatë, të thamtë e **lëkurëremët**. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 58); I tregoi **mirëbesueshëm** si ta kishte ndeshë e kuvendë me të, qindra herësh. (Shkundullima, Vepra, 4, f. 106) etj.

3. Përngjitja është një mënyrë tjetër fjalëformimi, me njësi dhe nga leksiku popullor, dhe nga ai vetjak, i autorit: Mëndeshja, përziente ploghtë tepricat e barishteve e i vidhte me sy **sibijës** ballin e zbehtë hjesmor... (Shkundullima, Vepra, 4, f. 111); Andaj i pëlqente ramja në gjumë ma tepër se jeta e **përditës** nëpër shtëpi e jashtë ndër ara, buzë lumit të madh. (Rrunggaja në mars, Vepra 4, f. 162); Papritmas mund të zbriste me kokrrën e rrëfësë në dorë apo si frymë e shndërrueme në shtërgatë, jo me përtrollë një anë jete, por me vu në vend çdo gja që të bijtë s'e kishin vu **përfije**. (Pishtarët..., Vepra 4, f. 9); E nisi për Gurra, i lidhi **mëgojën** prej 300 kile misër, simbas dokes së vjetër dhe e lamë atje në Fundinë. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 45); Nganjëherë, lumi i Vilës ishte i rritun **malemal**. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 65); Në atë **timtë** kujtoheshin se... (Shkundullima, Vepra, 4, f. 120); U ndanë të dy **prishakandas**. (Gjon Gazulli, Vepra 4, f. 263); Herë, herë edhe i kapërcente **këmbagjelas** (Djella, Vepra, 1, f. 60) Tha tue qeshë **dijekeqas** e me qëllim për të më fye. (Djella, Vepra, 1, f. 11); Ai nuk më mori vesh dhe qeshi **gazakeqas**. (Mprehje..., Vepra, 3, f. 91); Tash për tash s'di, por një ditë, ndoshta e tyej qafën **dikah** për t'u lëshue vend vëllezërve (Pishtarët..., Vepra 4, f. 22) Mbyllte vërtet të dy sytë si me dashë të shlyente nga **mbamendja** çdo përfytyrim të atyne burrave. (Pishtarët, Vepra 4, f. 79) etj.

4. Edhe nyjëzimi, sidomos ai i pjesoreve, sjell njësi më vlere për shqipen: Edhe në shekullin e kaluem, si sot e kësaj dite, thashethanat nuk kishin qenë të **çrranjosuna** prej gojës së gjindjes së këtyne viseve me lagje dhe shtëpi të **kokërrueme** brijash e luginash si të kishte qenë secila sosh dikur farë e **hjedhun** prej një grushti e ma vonë të ishin rritë të mëdha. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 17) Tregonin me za të **shqerrum**, maparë në familje, e mandej në udhë, mrekullitë që kish ba e shikue... (Shkundullima, Vepra 4, f. 126); Ndonjëherë iu duk se flente në një shtroje me gra të **fatueme** apo më ndonjë Zanë mali. (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 25); Shih, shih, - tha Nika në vete, fare i

paquem... (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 48); *Flente pak i sjellun në shpinë.* (Pishtarët..., Vepra, 4, f. 22) etj.

Në veprën e M. Camaj kemi shumë emra veprimi asnjnës, të cilët kanë vlera të theksuara stilistikore, por edhe denotative, duke nxjerrë në pah edhe një vlerë tjetër të leksikut gegë: *Bani dy-tri të sjelluna më not.* (Mprehje shqisash, Vepra, 3, f. 47); *Nuk iu ruejt të vetuemit të rrezeve të diellit.* (Mprehje..., Vepra, 3, f. 92) etj.

5. Shndërrimi i kategorisë leksiko-gramatikore (*konversioni*) është tjetër mënyrë fjalëformimi që në veprën e M. Camajt prek gati të gjitha njësitë emërtuese: *Andejna jemi nisë para njëzet e katër orësh dhe vetëm tashti ia përsjjetëm këtu: rrugë e largët!* (Rrunggaja në mars, Vepra, 4, f. 166); *Binje edhe në dugajën time ta shohim e të kuvendim pakëz me të.* (Pishtarët..., Vepra 4, f. 48); *Kthenin të dy dalë (ngadalë)...* (Shkundullima, Vepra, 4, f. 111); *I shtrihej tërkuzë vendit.* (Mprehje..., Vepra, 3, f. 67) etj.

Nuk mungojnë në vepër edhe formime prapavjatëse: *Kora (të korrat) ishte brendë e se vetëm këto e këto cikërrime punësh kishin mbetë pa u sosë...* (Pishtarët..., Vepra 4, f. 38); *I shtonte djegën (të djegurit / dëshirën) për të shti në dorë sa më shumë kësi frymëzorish të kushtueshëm.* (Pishtarët..., Vepra 4, f. 42) etj.

Me interes janë dhe toponamostika dhe onomastika në vepër. Autori përdor me vend fjalën shqipe: *Me më humb ditën paske ardhë deri në Fundinë?* (Pishtarët..., Vepra 4, f. 9); *Në kthim ajo ndeshte shtegtarë që vinin nga Përteqafa, njerëz që edhe në vapën ma të madhe mbanin tesha të leshta e të randa.* (Rrunggaja, 4, f. 166) etj.

Po kështu, në vepër gjejmë shumë fjalë të urta sjellin vlera në rrafshin leksikor etj.: *Rrasa kërkon vegshin.* (Rrunggaja..., Vepra 4, f. 180); *Edhe fjala ban mort.* (Lirika, Vepra 1, f. 103) etj.

Përmasa e fundit e prurjeve të M. Camajt në lami të shqipes, që nuk mund të anashkalohet kurrsesi, është pastërtia gati skajore nga huazimet e veprës së tij. Edhe ndonjë fjalë e huaj që shfaqet në fazën e fundit të krijimtarisë poetike, sikur e hijeshon veprën e tij.

Duke përfunduar, të gjithëve, por veçanërisht ne, leksikografëve, M. Camaj na ka lënë një amanet: *Leni lumejt të derdhen të gjithë në Adrie / dhe në detin Jon! Le ta çojmë në vend atë, le t'ia kthejmë shqipes së sotme fjalorin e munguar të këtij autori dhe të shkrimtarëve të tjerë të ndaluar, gjithmonë përmes një studimi e përzgjedhjeje shkencore.*